



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 29.01.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave, 20.12.2018, 21.12.2018, 27.12.2018, 10.01.2019 dhe 18.01.2019 nga anëtarët e Këshillit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:15 dhe mbaroi në orën 11:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Medi Bici** (anëtar)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Erjon Muharremaj** (anëtar)
- 11. Marçela Shehu** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të Ambasadës Amerikane.*

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave, 20.12.2018, 21.12.2018, 27.12.2018, 10.01.2019 dhe 18.01.2019 nga anëtarët e Këshillit.

Naureda Llagami: Përsëndetje!

Fillojmë mbledhjen.

Prezent janë të gjithë anëtarët e Këshillit.

Sikurse jeni vënë në dijeni nga materialet për mbledhje, sot rendi i ditës përmban, së pari, si çështje të parë “1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave, 20.12.2018, 21.12.2018, 27.12.2018, 10.01.2019 dhe 18.01.2019”. Pika e dytë e rendit të ditës është “2. Caktimi dhe publikimi i numrit maksimal të kandidatëve magjistratë, profili gjyqtarë, që do të pranohen në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020”. Dhe pika e tretë e rendit të ditës është “3. Ngritja e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kritereve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë”.

Lidhur me çështjen e parë të rendit të ditës, miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kjo çështje shtrohet për shqyrtim dhe miratim bazuar në nenin 69, pika 3 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Këto procesverbale të mbledhjeve të Këshillit u janë shpërndarë secilit prej

jush në rrugë elektronike nga administrata e Këshillit dhe duke qenë se deri tani nuk keni prezantuar ndonjë pasaktësi të tyre, po ju ftoj për miratimin e tyre në këtë mbledhje.

Jeni dakord me miratimin e procesverbaleve respektive?

Kalojmë për votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 29.01.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Caktimi dhe publikimi i numrit maksimal të kandidatëve magjistratë, profili gjyqtarë, që do të pranohen në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:15 dhe mbaroi në orën 11:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Medi Bici*** (anëtar)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të Ambasadës Amerikane.*

RENDI I DITËS:

2. Caktimi dhe publikimi i numrit maksimal të kandidatëve magjistratë, profili gjyqtarë, që do të pranohen në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek çështja e dytë e rendit të ditës. Caktimi dhe publikimi i numrit maksimal të kandidatëve magjistratë, profili gjyqtarë, që do të pranohen në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020. Kjo çështje shtrohet për shqyrtim dhe miratim ditën e sotshme, si një detyrim i Këshillit që buron nga neni 29, pika 1 e ligjit 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në të cilën parashikohet shprehimisht se, në janar të çdo viti, Këshillat, pasi kanë kryer një analizë të nevojave, përcaktojnë dhe publikojnë numrin maksimal të kandidatëve magjistratë që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik.

Në këtë kuadër, nga ana jonë, është zhvilluar një korrespondencë me Shkollën e Magjistraturës, për të bërë të mundur që në përcaktimin dhe publikimin e numrit maksimal të kandidatëve magjistratë që do të pranohen në formimin fillestar për vitin akademik 2019-2020, të jemi sa më afër nevojave të sistemit gjyqësor, por edhe duke marrë parasysh edhe kapacitetet që ka Shkolla e Magjistraturës. Për këtë çështje, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur një projekt-vendim, së bashku me

relacionin shoqërues dhe për më tepër detaje dhe shpjegime po ia jap fjalën zotit Toska, në cilësinë e kryetarit të komisionit.

Ilir Toska: Atëherë, faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, në përmbushje të detyrimeve ligjore që e ngarkojnë Këshillin e Lartë Gjyqësor, referuar ligjit, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 29, sikundër edhe detyrimeve ligjore që burojnë nga neni 53 dhe 55 të ligjit, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, i propozon Këshillit të përcaktojë numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020, sa i përket magjistratëve për profilin gjyqtar, sikundër edhe sa i përket këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë.

Në relacion përmenden të gjithë faktorët që neve kemi konsideruar sa i përket numrit që kemi propozuar, 25 (njëzet e pesë) sa i përket numrit të kandidatëve për magjistratë për profilin gjyqtar dhe 25 (njëzet e pesë) sa i përket numrit të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë.

Kemi konsideruar sa i përket numrit të magjistratëve, vendet vakant që ka aktualisht sistemi; kemi konsideruar vendet vakant në pozicionet e lira, në termin që përcakton legjislacioni aktualisht në fuqi (pozicione të lira të përhershme); kemi pasur në konsideratë pozicionet e lira të përhershme që do të bëhen në periudhën në vijim; kemi pasur në konsideratë edhe proceset e tjera që interferojnë me krijimin e pozicioneve të lira në sistemin gjyqësor, siç është procesi i vlerësimit kalimtar; pastaj produkti i deritanishëm apo i tendencës së këtij procesi, kemi pasur në konsideratë edhe faktin që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përgjegjësi të hartojë një hartë të re të sistemit, të organizimit të gjykatave, e cila mund të riplanifikojë numrin e gjyqtarëve nëpër gjykata apo një rishpërndarje të tyre; kemi pasur në konsideratë edhe faktin që për procese të ndryshme ligjore që mund të çojnë në krijimin e pozicioneve të lira, siç mund të jenë proceset disiplinore apo procedimet penale ndaj gjyqtarëve që mund të rezultojnë më tej në shkarkim nga detyra të tyre; kemi pasur në konsideratë edhe kapacitetet e Shkollës së Magjistraturës, referuar informacionit të dhënë nga Shkolla e Magjistraturës, informacion ky i datës 21 janar i vitit 2019, ku referohet se kapaciteti maksimal i Shkollës është 75

vende, pra për të gjithë kandidatët për magistratë, qoftë profili gjyqtar, qoftë profilit prokuror, përfshirë edhe për këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë.

Në mënyrë të detajuar, të gjithë faktorët që janë pasur në konsideratë kanë terma konkret në relacionin shpjegues që i është bashkëlidhur projekt-vendimit.

Kemi pasur në konsideratë, sipas ligjit, se Shkolla e Magjistraturës ka detyrimin ligjor që të pranojë në provim kandidatë qoftë në profilin gjyqtar dhe për profilin e prokurorisë. Ndërkohë që, sa i përket numrit të kandidatëve për profilin prokuror, është Këshilli i Lartë i Prokurorisë ai që përcakton këtë numër.

Duke pasur në tërësi numrin e përgjithshëm që Shkolla mund të mundësojë formimin fillestar, që është 75, kemi konsideruar që një ndarje proporcionale të kandidatëve për profilin gjyqtar, prokurorë dhe magistratë, ndërkohë që në projekt-vendim, duke pasur parësore nevojën imediate të sistemit për magistratë, profilit gjyqtar, kemi konsideruar që nëse do të ketë kandidatë që do të kalojnë provimin dhe të marrin pikët kualifikuese për sa i përket pranimit në Shkollën e Magjistraturës për programin e formimit fillestar, për magistratë të profilit gjyqtar, numri i tyre të rritet në raport me numrin e ndihmësve. Këto janë parashikuar tek pika 1, germa /c/ dhe /d/, që konsistojnë që nëse ka më tepër kandidatë që plotësojnë kërkesat për gjyqtarë, ky numër të rritet në dëm të numrit të këshilltarëve apo ndihmësve ligjorë, duke konsideruar se sistemi ka nevojë parësore për të pasur të plotësuar pozicionet e punës me gjyqtarë të cilët duhet të japin vendimin, por duke mos injoruar faktin që edhe gjyqtari ka nevojë për të pasur ndihmës për të operuar për një ngarkesë pune e cila gjithmonë sa vjen e rritet në gjykatat tona. Këto ishin me pak fjalë.

Kemi konsideruar të përcaktojmë edhe kriteret për ndihmësit ligjorë dhe këshilltarët. Në fakt ligji konsideron që duhet të përcaktojmë referuar kritereve të përgjithshme sipas ligjit të “Statusit të nëpunësit civil”, ndërkohë, sa i përket kritereve të veçanta, ato parashikohen në ligjin “Për pushtetin gjyqësor”.

Kemi dhënë një propozim për sa i përket kritereve që duhet të plotësojnë, sipas Komisionit të Karrierës, ndërkohë që pashë që është edhe një propozim nga një prej anëtarëve, që na është depozituar, sa i përket kritereve të veçanta, veçantë për këshilltarët

ligjorë dhe veçantë për ndihmësit ligjorë. Mund të jetë një propozim me vlerë që mund të konsiderohet në diskutimet e mëtejshme.

Ndërkohë, sipas ligjit “Për pushtetin gjyqësor”, sa i përket numrit të këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë, ligji kërkon që paraprakisht Këshilli të marrë mendimin e kryetarëve të gjykatave dhe konsideruam që për vitin aktual nuk kishim nevojë të merrnim një mendim të tillë, sa kohë që jemi të vetëdijshëm që në gjykatat e apelit, ku ndihmësit ligjorë duhet të pozicionohen, nuk ka ndihmës ligjorë, përjashtuar Gjykatën e Apelit Administrativ. Ndërkohë që sa i përket këshilltarëve ligjorë në Gjykatën e Lartë, nga informacioni që kemi marrë, ai numri i përgjithshëm që është efektivisht pranë Gjykatës së Lartë në pozicione pune është 9 momentalisht. Këto janë informacione të detajuara që janë në relacionin shpjegues. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Sikurse ju referuat, është administruar sot një propozim lidhur me ndryshimin e pikës 6 të projekt-aktit që ju sqaruar. Ky propozim është bërë nga zonja Brikena Ukperaj, të cilës po i jap fjalën për të na sqaruar propozimin për ndryshimin e projekt-aktit të propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Brikena Ukperaj: Atëherë, paraprakisht do të shprehem pak edhe për pikat e tjera të projekt-vendimit të propozuar. Nuk kam diçka tjetër për të shtuar. Mendoj që rekomandimet dhe projekt-vendimi i përgatitur nga Komisioni i Karrierës është ezaurues për sa i përket kriterëve që duhet të merren parasysh në përcaktimin e numrit për kandidatët magjistratë, këshilltarë ligjorë dhe ndihmës ligjorë.

Ndryshimi në propozim në fakt i përket pikës 6, nisur nga parashikimet që bën ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” lidhur me kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta për kandidatët për këshilltarë ligjorë që nuk janë magjistratë, duke marrë parasysh që përbërja e këshilltarëve ligjorë në Gjykatën e Lartë është e tillë që më shumë se gjysma duhet të jenë ndihmës magjistratë dhe pjesa tjetër duhet të vijë nga këshilltarë ligjorë që ndjekin trajnimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe për pjesën e ndihmësve ligjorë që është një risi e ligjit për sa i përket gjykatave të apelit (juridiksionit të zakonshëm), duke qenë se Gjykata e Apelit Administrativ deri tani ka operuar me ndihmës ligjorë.

Propozimi im është më tepër një detajim të kriterëve që duhet të kemi parasysh dhe që duhet të vendosë Këshilli, si atribut i tij, lidhur me kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta që duhet të parashikojmë për pozicionin e këshilltarit ligjor më vete dhe të ndihmësit ligjor në gjykatat e apelit.

Në kushtet e përgjithshme janë të gjitha ato që parashikon ligji “Për statusin e nëpunësit civil” ku referon edhe vetë neni 55 i ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”. Në fakt, referuar dispozitës, jepet atributi i Këshillit që mund të përcaktojë kriteret e përgjithshme për sa i përket arsimimit dhe përvojës profesionale dhe kjo gjë është reflektuar nga Komisioni i Karrierës lidhur me notën mesatare të përgjithshme mbi 7. Është pika /d/ e ndryshimit të propozuar prej meje, ku në kushte të përgjithshme mendoj që duhet të parashikohen: *a) është shtetas shqiptar; b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; c) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, me diplomë “Master i shkencave”, ose i barasvlershëm me të; d) nota mesatare mbi 7 (shtatë), si dhe notë mesatare mbi 7 (shtatë) për grupin e lëndëve kryesore, sipas përshkrimit; e) të mos jetë i dënuar me vendim penal të formës së prerë; f) të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990; g) të mos ketë qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete; h) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore si dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi.*

Në fakt, të gjitha këto kriteret janë parashikuar edhe në propozimin e bërë nga Komisioni i Karrierës, mendoj se duhet të grupohen si kriteret e përgjithshme që duhet të plotësohen si nga kandidatët për këshilltarë, ashtu edhe për ata për ndihmës ligjorë. Në fakt, ligji bën një klasifikim vetëm të kriterëve të veçanta, të cilat në vlerësimin tim duhet të parashikohen, për këshilltarët ligjorë jo magjistratë më vete, ashtu siç bën neni 56 në pikën 3 të tij dhe nuk është gjë tjetër veçse referimi në ligj që unë kam bërë në përcaktimin e këtyre kriterëve, pra: *a) përvoja profesionale jo më pak se 10 vjet si nëpunës i lartë në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare; b) njohuri në jurisprudencën e gjykatave vendase dhe atyre ndërkombëtare; c) njohuri shumë të mira të paktën të një gjuhe të vendeve të Bashkimit Evropian; d) aftësi të*

shkrimit dhe arsytimit ligjor; e) të jetë autor i artikujve dhe botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës (është konkretisht neni 56, pika 3 e ligjit, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”). Ndërsa si kriter i veçantë për pozicionin e ndihmësit ligjor është vetëm: a) përvoja profesionale jo më pak se pesë vjet, duke përfshirë së paku tre vjet profesionale që lidhet me gjykatën.

Naureda Llagami: Ka ndonjë diskutim mbi propozimin?

Po, zoti Muharremaj!

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Kisha vetëm një pyetje për zonjën Lubonja, si propozuese e amendimit.

Vërej mos përfshirjen e kushtit për këshilltarin ligjor që të mos ketë masë disiplinore në fuqi në pozicionet e mëparshme. Ka ndonjë arsye specifike?

Brikena Ukperaj: Ky nuk është kriter i veçantë për këshilltarët. Është kriter i përgjithshëm, si për ndihmësit ligjorë ashtu edhe për këshilltarët dhe referimin e bëjmë tek statusi i nëpunësit civil, që nuk duhet të ketë masë disiplinore.

Erjon Muharremaj: Okej!

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, konsiderojmë, pasi diskutuam edhe me kolegët, që propozimi që bën anëtarja Lubonja në lidhje me ndryshimin e pikës 6, të konsiderohet nga ana e Këshillit dhe të miratohet, pra propozimi ynë të reflektoj pikërisht këtë ndryshim që propozohet.

Naureda Llagami: Pra, kjo do të thotë që kur të ta hedhim aktin në votim, ta pranojmë edhe propozimin e zonjës Brikena Ukperaj për pikën 6 të projekt-aktit. Okej!

Brunilda Kadi: Më fal! Për këtë propozimin, tek kriteret e veçanta, pika /b/, /c/, /d/, /e/, ju jeni referuar...

Brikena Ukperaj: 56, pika 3, që referon në nenin 34, pika 6 e ligjit.

Brunilda Kadi: Cila pikë ishte? 34, pika 6.

(Zonja Ukperaj përgjigjet pa ndezur mikrofonin.)

Brikena Ukperaj: Këshilltarët ligjorë jo magjistratë duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme dhe e ke /a/ deri në /e/. E para është kriter i përgjithshëm sepse flet edhe për

ndihmësit ligjor dhe të tjerat shkojnë si kritere të veçanta, edhe masat disiplinore gjithashtu. Neni 34, pika 6.

Brunilda Kadi: E paska tek ligji, se në fakt...

Naureda Llagami: Diskutime të tjera lidhur me pranimin e propozimit të bërë nga kolegja Ukperaj?

Medi Bici: Vetëm një diçka kisha.

Naureda Llagami: Po!

Medi Bici: Për notën mesatare.

Brikena Ukperaj: Nota mesatare vjen propozim në fakt...

Medi Bici: Ta sqaroj, që mos ta marrë fjalën më.

Brikena Ukperaj: Po!

Medi Bici: Është shumë e rëndësishme që niveli i ndihmësve ligjorë, të paktën, në mos shumë i mirë, të jetë i mirë e sipër, sidomos për Gjykatën e Lartë. Do propozoja notën mesatare 8 (tetë).

Ilir Toska: Atëherë, sa i përket kriterit të notës, ligji nuk ka një përcaktim konkret. Kemi pas në konsideratë faktin që, ato që kemi nevojë që të hynë si këshilltarë dhe si ndihmës ligjorë, të kenë një cilësi të caktuar arsimore. Kemi pas në konsideratë, sa i përket kritereve për magjistratë, profili gjyqtar apo prokuror, është caktuar si kriter nota 8 (tetë) dhe konsideruam që nota për ndihmësit ligjorë dhe këshilltarët të jetë 7 (shtatë), që mos të barazojmë të njëjtat kritere me ato për magjistratë. Kjo është arsyeja që konsideruam notën 7 (shtatë).

Fillimisht në komision konsideruam nëse duhet të përcaktonim një kriter note apo jo, si kriter për pranimin në provim. Menduam se ligji nuk është se na detyron të përcaktojmë një kriter të tillë. Konsideruam që ta vendosim një kriter të tillë, që të pamundësojmë apo dekurajojmë aplikimin e kandidatëve që nuk kanë cilësitë e duhura arsimore për t'u përfshirë në një provim, që sipas gjasave do të dështonin. Prandaj vumë si më logjike kriterin e notës dhe përcaktuam notën 7 (shtatë).

Maksim Qoku: Në vijim të kësaj, ndihmesat, a do ishte e mundur, sikurse edhe me mesataren, të mund të mos përfshinim pikën 3 "...të jetë autor i artikujve dhe botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës"?

Ilir Toska: Ajo është për këshilltarët ligjorë dhe e ka ligji.

Maksim Qoku: Është për këshilltarët kjo, jo për ndihmësit?

Okej!

Brikena Ukperaj: Është kërkesë e ligjit.

Për të sqaruar diçka. Nuk është se unë në propozimin tim kam referuar propozime te parashikimeve ligjore. Thjesht është referenca e ligjit. Për të qenë më konciz në atë çfarë e parashikon ligji.

Maksim Qoku: Dhe e dyta, në lidhje me atë rregulloren, për referimin e kuotave, domethënë nëse ka magistratë që e kalojnë atë pikëavarazhin që kërkohet në provim dhe marrin nga kuotat e..., a është mirë që të parashikohet në aspektin e ndërhyrjes, të themi që 30 (tridhjetë) magistratë marrin dhe e kalojnë me 5 (pesë) kuotat e tyre, pra marrin pikët, ndërkohë që 22 (njëzet e dy) marrin nga ato, dhe kemi një ndërhyrje midis kuotave. A mundet këto që t'i marrin 5 (pesë) kuota dhe të lejnë jashtë 3 (tre) nga jo magistratët? Më kupton, ndërhyrja midis 25-ve. A mos është mirë ta parashikojmë? Pra e kam fjalën, nga 25 (njëzet e pesë) që janë kuotat për magistratët, fitojnë 30 (tridhjetë), pra kapin pikëavarazhin (minimumi pra), ndërkohë që nga 25 (njëzet e pesë) të kuotave të dyta, marrin 22 (njëzet e dy), pra lejnë vetëm 3 (tre) kuota. Tani, 3 (tre) do marrin? Do marrin 5 (pesë) dhe do lejnë 2 (dy) jashtë?

Po pra, do lejnë 2 (dy) jashtë? Prandaj po them.

Se në themi 25 (njëzet e pesë) me 25 (njëzet e pesë), pika /a/ dhe /b/.

Ilir Toska: Atëherë, po përpiqemi të hamendësojmë shumë situata, por ajo që kishim në logjikën tonë ishte që, nëse ka numër kandidatësh për magistratë, profili gjyqtar, që arrijnë të marrin provimin dhe kualifikohen mbi 60% të pikëve, numri i kuotave për magistratë, të rritet në dëm të... teorikisht deri në 50 (pesëdhjetë). Nëse arrijmë të kemi më shumë gjyqtarë kalues në provimin për gjyqtarë, këtë kemi konsideruar kur kemi bërë ato dy parashikimet, që t'i lejmë mundësi të hapur që nëse vërtetë ka kandidatë dhe kualifikohen në provim, ky numër të jetë më i madh në raport me gjyqtarët.

Naureda Llagami: Ndonjë diskutim tjetër para se ta hedhim për votim?

Ilir Toska: Referuar faktit, propozimit që bëri zonja Lubonja, duhet të reflektojmë edhe nenin 56, tek baza ligjore e vendimit. Neni 56, pika 3 e ligjit “Për pushtetin gjyqësor”. Pra pas fjalës “...neni 53, pika 1” (*lapsus, neni 55, pika 1*), të shtohet “...neni 56, pika 3”.

Naureda Llagami: Atëherë, për të qenë sa më transparent tek mënyra e votimit dhe se si do të hedhim aktet për votim, aktin, duke qenë se komisioni përkatës e pranoi propozimin e zonjës Ukperaj, do të hidhet në votim së bashku me propozimin e bërë të zonjës Ukperaj. Jeni dakord tani të votojmë aktin në tërësi bashkë me propozimin? Kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-vendimin mbi numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020, sipas propozimit të bërë nga kryetari i Komisionit të Karrierës dhe propozimit të bërë nga zonja Ukperaj.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 29.01.2019)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Ngritja e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriteve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:15 dhe mbaroi në orën 11:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Medi Bici | (anëtar) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 11. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
2. *Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
3. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
4. *Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
5. *Përfaqësues të Ambasadës Amerikane.*

RENDI I DITËS:

3. Ngritja e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriterëve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë.

Naureda Llagami: Kalojmë tek pika e tretë e rendit të ditës që lidhet me ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriterëve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë.

Sikurse jeni në dijeni, për zbatimin e vendimit të sapo miratuar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka gjykuar që për të verifikuar kriteret ligjore të kandidatëve për këshilltarë dhe ndhmës ligjorë, është e nevojshme që të ngrihet një komision i posaçëm i cili do të merret me ‘skrinin’ (*screen-in*) dhe me kontrollin e këtyre kriterëve. Për më shumë detaje, fjalën ia jap sërish kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, zotit Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës konsideroi që është e nevojshme ngritja e një Komisioni të Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriterëve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, sepse ligji detyron Këshillin e Lartë Gjyqësor të miratojë të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret formale që ne përcaktuam më parë. Sa kohë që kjo do jetë pjesë e një vendimmarrjeje të Këshillit, do duhet dikush

nga Këshilli që të japë një propozim dhe të bëjë një verifikim paraprak të këtyre kritereve. Konsideruam që të ngrihet një komision i përkohshëm me tre anëtarë, që mund të ezaurojë këtë proces të verifikimit të ankesave, të mbikëqyrë pranimin e çdo aplikimi, që në fund të kemi një rezultat përfundimtar, mbi të cilin Këshilli të mund të marrë një vendim.

Naureda Llagami: Diskutim?

Brunilda Kadi: Kam një pyetje për komisionin.

Naureda Llagami: Po, zonja Kadi!

Brunilda Kadi: Është e vështirë, e pamundur që mund ta bëjë komisioni juaj këtë, apo është...? Si e shikoni në raport me ligjin edhe me pjesën praktike?

Ilir Toska: Atëherë, sa kohë kemi konsideruar që të ngrihet një komision, kemi konsideruar mbingarkesë momentale të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës të bëjë edhe këto detyra të tjera, se vetë jemi të ndërgjegjshëm që për momentin vetëm komisioni ynë ka shumë problematika që duhet t'i trajtojë. Nëse shumica e Këshillit mendon se ky komision duhet të mbajë edhe këtë barrë, s'është ndonjë problem, por çështja është të shpërndajmë edhe punën, që të kemi efektivitet në fund.

Naureda Llagami: Ka diskutim tjetër?

Ta kalojmë për votim?

Hidhet në votim projekt-akti i propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës mbi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kritereve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë që do të pranohen për të ndjekur programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik, sipas përmbajtjes së propozuar nga ky komision.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, projekt-vendimi është miratuar nga Këshilli.

Në kushtet që, në bazë të përmbajtjes së projekt-vendimit i është lënë Kryetarit që të propozojë anëtarët e këtij komisioni, unë përfitoj nga rasti që të bëj propozimet e mia përkatëse, të paktën për një anëtar, duke ftuar anëtarët e tjerë që të bëjnë propozimet e tyre.

Për anëtarin jo gjyqtar, unë do të propozoj zotin Erjon Muharremaj.

Kështu që për anëtarin gjyqtar, pres bashkëpunimin nga kolegët.

Ilir Toska: Atëherë, unë propozoj zonjës Brunilda Kadi të jetë pjesë e këtij komisioni.

Brunilda Kadi: Unë propozoj zonjën Ukperaj.

Naureda Llagami: Atëherë, përbërja e komisionit është zoti Erjon Muharremaj, në cilësinë e kryetarit të komisionit (propozimi), zonja Brunilda Kadi dhe zonja Brikena Ukperaj, në cilësinë e anëtarëve.

E kalojmë në votim?

Po, kryetar! Kryetar pra, ashtu e thashë. Propozimi im është për kryetar.

E kalojmë në votim përbërjen e komisionit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

(Me miratimin e përbërjes së komisionit të përkohshëm, sa më sipër, deklarohet e mbyllur edhe mbledhja plenare.)

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor